



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER EDLIRA R. TELHARAJ
ADRESA Rr. "ISMAIL QEMALI,
PALL. NR. 12, Kt. I - TIRANE"
TEL: 672072286

KONTRATË DHURIMI PASURI E

LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 95

Nr. koleksioni: 64

Tirane më 19/01/2024

Ligjet referuese:

1. Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
2. Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
3. Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024052800007053833

***Akti noterial përbëhet nga 3 fletë**



A202405280000053833

KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

Sot, më datë 13.1.2024, para meje Notere EDLIRA R. TELHARAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, Rr. "ISMAIL QEMALI, PALL. NR. 12, Kt. I - TIRANE", u paraqit personalisht:

DHURUES:

Irida Çela, atësia Fatos, amësia Shpresa, shtetase Shqiptare, lindur në Skrapar dhe banuese në Tiranë, me adresë Njesia 2 M.Grameno; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 2; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 01/05/1983, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me ID nr. 038021302 dhe nr. personal I35501092F, përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e huaj", e apostiluar në datë 12/01/2024, nga përfaqësuese Shpresa Sulaj, atësia Servet, amësia Florije, shtetase shqiptare, lindur në Shkodër dhe banuese në Tiranë, me adresë Todi Shkurti; Nd. .; ; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia bashkiake nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 20/10/1960, gjendja civile e martuar, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e së cilës u garantova nga karta e identitetit me nr. personal G06020050P. dhe

(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Dhuruesi")

PRANUES I DHURIMIT:

Laureta Çela, atësia Veis, amësia Begsa, shtetase Shqiptare, lindur në Fier dhe banuese në TIRANË, me adresë Petro Nini Luarasi; Nd. 5; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 05/01/1955, gjendja civile "e ve", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032756898 dhe nr. personal F55105041P.

(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Përfituesi i dhurimit")

te cilet, ne baze te Ligjit Nr.110/2018 dt.20.12.2018 "Per Noterine" nenit 705 e vijues te Kodit Civil, si dhe ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate si vijon:

TË DHËNA PARAPRAKË:

- A. Shoqëria "47 EK 79& ILIRIADA P.K.S" sh.p.k, është regjistruar si person juridik prane QKB-se, me NIPT K82422001O, me kapital themeltar me vlerë 200.000 Leke (dyqind mijë lekë) dhe ka status aktiv.
- B. Dhuruesi eshte ortak ne kete shoqeri dhe pronar i nje kuote te barabarte me 40% pjese te kapitalit te shoqerise "47 EK 79& ILIRIADA P.K.S" sh.p.k me vlere te kapitalit 80.000 leke (tetedhjetë mijë leke).
- C. Kuota e kapitalit qe Pala dhuruese zoteron ne shoqerine "47 EK 79& ILIRIADA P.K.S" Sh.p.k me NUIS K82422001O, nuk janë të rënduar me barrë apo kufizime të tjera në favor të të tretëve sikurse rezulton nga Regjistri i barreve siguruese.



D. Dhuruesi dëshiron ti dhurojë pranuesit të dhurimit: 40% nga pjesa e tij që zoteron në kapitalin e shoqërisë nga kuota që zotëron (e cila, në raport me gjithë kapitalin e shoqërisë është në masën 40%, vlera nominale e dhurimit është 80.000 lekë, pa asnjë kusht apo barrë, Pranuesit të Dhurimit, i cili pranon sipas aktit në vijim;

Në këto kushte, Palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti i kontrates

- 1.1 Objekt i kësaj kontrate është kalimi pa kundershperblim, nga Dhuruesi të Pranuesi i Dhurimit i: 40 % (*dyzet përqind*) pjesë të kapitalit në zotërim të dhuruesit, vlera nominale e të ciles 80.000 lekë, pjesëmarrje kjo që perben 40 % pjesë të gjithë kapitalit të shoqërisë.
- 1.2 Zhveshja e Dhuruesit nga të drejtat dhe detyrimet që buronin nga qenia pronar mbi këtë pjesëmarrje objekt i dhurimit, të lindura nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.

NENI 2 Kalimi i pronësisë

- 2.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate realizohet kalimi i: 40 % të pjesëve të kapitalit total të shoqërisë "47 EK 79& ILIRIADA P.K.S" Sh.p.k", nga Dhuruesi të Pranuesi i Dhurimit dhe Dhuruesi zhvishet nga të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia mbi këto pjesë të lindura pas momentit të nënshkrimit të këtij akti.
- 2.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate Pranuesi i Dhurimit bëhet zotëruar i 40 % të pjesëve të kapitalit të shoqërisë "47 EK 79& ILIRIADA P.K.S" Sh.p.k, duke marrë persiper të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga qenia pronar, lindur nga momenti i nënshkrimit.
- 2.3 Me pranimin e dhurimit të pjesëve në total në masën 40 % të kapitalit të shoqërisë, Pranuesja e dhurimit Laureta Çela bëhet ortakë në shoqëri dhe zotëruar e 1 (një) kuote, e cila përfaqëson 40% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë me vlerë nominale 80.000 lekë.

NENI 3 Deklarime të palëve

- 3.1 Dhuruesi deklaron dhe garanton Pranuesin e Dhurimit se, pjesët e kapitalit të shoqërisë, që i transferohen Pranuesit të Dhurimit, pa kundershperblim me kushtet me sipër, janë të lira nga çdo barrë apo rëndesë tjetër, dhe menjëherë lirisht të transferueshme të të tretet dhe mbi to nuk ka asnjë të drejtë juridike të të tretëve përveç Pranuesit të Dhurimit.
- 3.2 Pranuesi i Dhurimit, deklaron se e njeh gjendjen e shoqërisë, e pranon transferimin nëpërmjet dhurimit në favor të tij, duke marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet që do të burojnë nga qenia pronar mbi këtë pjesë të kapitalit objekt dhurimi.

NENI 4 Data efektive e kontratës

- 4.1 Kjo kontratë është e përvokueshme, e pakthyeshme, efektive, e detyrueshme për palët dhe trashëgimtarët e tyre, që nga data e nënshkrimit të saj.

NENI 5 Zgjidhja e Kontratës

- 5.1 Asnjë nga palët nuk mund të zgjidhë në mënyrë të njëanshme këtë Kontratë.

NENI 6 Hartimi i Kontratës



- 6.1 Kontrata u hartua në 4 (kater) kopje të barazvlershme, në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë ligjore.
- 6.2 Kjo Kontratë dhe kalimi i kuotave nga Dhuruesi tek Pranuesi i Dhurimit do të regjistrohet nga palet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) brenda afatit ligjor ne rast te kundert palet moren dijeni per aplikimin e penaliteteve per vonese ne aplikim.

NENI 7

Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni

- 7.1 Kjo Kontratë është hartuar ne bazë të legjislacionit shqiptar dhe konkretisht të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- 7.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj Kontrate, nëse vetë palët me ndihmë juridike vazhdojnë të mos t'i kuptojnë e zbatojnë, si dhe në rast se vetë palët nuk gjejnë mirëkuptim, mosmarrëveshjet bëhen objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 8

Interpretimi i Kontratës në tërësi

- 8.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.

Kontrata iu lexua palëve me zë të lartë e të qartë nga unë Noteri u lexua prej perkthyesit prezent i cili perktheu aktin ne pranine time nga gjuha shqipe ne Gjuhen Angleze, gjuhe te cilen Dhuruesi deklaroi se e njeh teresisht e per kete u sigurova edhe nga pohimet e perkthyesit. Pasi palet deklarojne se e gjejne ate te rregullt e ne perputhje me vullnetin e tyre te lire e te plotë (pala e huaj konfirmohet edhe nga perkthyesi) une noteri pasi u sigurova persa me siper, lejoj nenshkrimin ne pranine time dhe e legalizoj regullisht, ne perputhje me ligjin.

PALET

DHURUES

Irida Çela

Perfaqesuar me prokure nga:

Shpresa Sulaj



NOTER

EDLIRA R. TELHARAJ

PRANUES DHURIMI

Laureta Çela



Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

REZULTATET E KERKIMIT

Numri i Rezultatit te kerkimit: D-20240119160000451
Data e Rezultatit te Kerkimit: 19.01.2024
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 16:00:00
Lloji i Kerkimit: Emri i Personit Fizik
Numri i Dokumentit: D-400-577-914

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0

IRIDA FATOS CELA

Fundi i Rezultatit te Kerkimit

Fundi i Dokumentit



Ada Croya